

KËRKESË

Lenda; Për heqjen dorë apo përjashtimin nga pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

Drejtuar; Z. Ardian DVORANI

Kryetar

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

I nderuar zoti Kryetar,

Në respekt të nenit 222, 223 dhe 224/2 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" si dhe nenit 2 dhe 14, pika 1 dhe 2 të Rregullores "Për funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi", miratuar me vendimin nr. 1, datë 08.02.2019 nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ju parashtroj kërkesën time për miratimin e mospjesmarrjes sime në mbledhjet e ardhshme, siç është edhe ajo e datës 15.02.2019, ku do të trajtohen çështje që kanë për objekt përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e rregullave normative të shortit, verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatëve, si edhe në procedurat konkrete të shqyrtimit të kandidimeve për pozicionet vakante të paraqitura nga Presidenti i Republikës, pasi ndodhem në kushtet e pengesës ligjore dhe papajtueshmërisë.

Parashtroj këtë kërkesë pasi konstatoj se një ndër kandidatët që ka aplikuar pas thirrjes për aplikim për plotësimin e vakancave të krijuara për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, të bërë nga Institucioni i Presidentit të Republikës me dekretet 10722, 10723, datë 07.02.2018 dhe 10946, datë 09.11.2018, është znj. Ardita Alsula (Buna), motra e bashkëshortit tim (kunata).

Në respekt të ligjit, por edhe të një procesi sa më të rregullt dhe të pakonstestueshëm, lutem të merrni në shqyrtim këtë kërkesë.

Me respekt,

Tirane me;14.02.2019

FATJONA MEMÇAJ

ANETARE E KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI

